# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-437087**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rusia godet pikat e karburanteve në Kiev – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/rusia-godet-pikat-e-karburanteve-ne-kiev/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 15:13:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 15:09:16 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `40b3451edb5cf3a37d13247dbc309d1734fff0f8aa335603a8ee4850dd7383ba` |
| TEKSTI | `7be37a3b63f4baf86cb726ff3c84a7f498ab3bbdfeb02ad010bf98dafcb9f973` |
| PAMJA | `0dab9a7bac30c32b84a665981056d8948f933cd90b928cac3190a319cb2a5c9a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2f68cd893c3ae378826da741b3fc81daa378efac375d9a74cdc3384d20c98aed` |
| E MËPARSHMJA | `04f106e4eb0f62aea1c8eddfb94fe923a0775834ed7546277c32d2320cc456b6` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2f68cd893c3ae378826da741b3fc81daa378efac375d9a74cdc3384d20c98aed`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Të paktën dy persona humbën jetën dhe 12 të tjerë u plagosën nga goditjet në dy pika karburanti të premten në mëngjes, sipas kryetarit të bashkisë së qytetit, Vitali Klitschko, shkruajnë mediat e huaja.

Sulmet e kryera gjatë orarit të pikut të trafikut pasojnë një sulm të ngjashëm ndaj një pike karburanti të enjten, i cili ishte i pari i këtij lloji në kryeqytet.

Në pikën e karburantit "Ukrnafta" në lagjen Pochaina, në veri të Kievit, dëshmitarët thanë se tre persona ishin plagosur nga shpërthimi i së premtes: menaxheri i një lavazhi aty pranë, bashkëshortja e tij dhe drejtuesi i një makine që po kalonte. Automjeti i shkatërruar kishte mbetur në anë të rrugës; xhamat ishin thërrmuar dhe sediljet ishin spërkatur me gjak.

Dëshmitarët thanë se kishin dëgjuar dy shpërthime dhe autoritetet vendase deklaruan më vonë se Rusia kishte kryer një sulm të dyfishtë (të njohur si "double-tap") ndaj objektit.

"Kjo është ndoshta një nga periudhat më të vështira të luftës,…", ka thënë Anastasiia Demchenko, 30 vjeçe, e cila punon në një kompani dërgesash përballë pikës së karburantit. "Të krijohet ndjesia se jeta është në tehun e thikës".

Të tre sulmet kishin në shënjestër pika karburanti të operuara nga "Ukrnafta", një kompani shtetërore për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror.

Sergiy Fedorenko, ushtruesi i detyrës së kreut të "Naftogaz" (kompania

5 Nafta "kapërcen" 230 lekë për litër, ekspertët: Gabimi që na bën të kemi…

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

mëmë e "Ukrnafta"), tha: "Nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë objektiv ushtarak pas sulmeve të tilla. Ky është terror i drejtuar ndaj popullatës civile, ndaj njerëzve paqësorë".

Të mërkurën, në Telegram filloi të qarkullonte një listë me 18 pika karburanti në Kiev që parashikohej të goditeshin nga dronët rusë.

Dhe të tri pikat e goditura deri më tani ishin në atë listë.

Kievi është goditur vazhdimisht çdo ditë nga dronët dhe raketat që nga fundi i gushtit, në një kohë kur Ukrainës po i mbarojnë raketat përgjuese "Patriot".

Një pauzë e shkurtër gjatë fundjavës, për shkak të vizitës së të dërguarve amerikanë Jared Kushner dhe Steve Witkoff, përfundoi të hënën.

Sulmet ndaj pikave të karburantit ndodhën ndërsa Volodymyr Zelensky ndodhej në një udhëtim jashtë vendit, me qëllim sigurimin e mbështetjes dhe ndihmës ndërkombëtare përpara asaj që pritet të jetë një dimër i vështirë.

Të enjten, presidenti ukrainas u takua me kryeministrin e Kanadasë, Mark Carney, i cili ofroi mbështetje për të ndihmuar në shtimin e rezervave të dronëve të Ukrainës.

#Karburantet #Kiev #Rusia #VizionPlus

**Taulant Halili**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh




BOTA

**Sulm me dron ndaj një anijeje ruse në Detin...**

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë



BOTA

**Trump i kërkon Zelenskyt të...**

Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë



BOTA

**Tragjedi! Përmbyset anija me pasagjerë,...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 23:17

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.